



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 5168 Prot

Lezhë, më 11 / 5 /2023

VENDIM

Nr. 39, Datë 10 . 05 .2023

Për përdorimin e fondit të emergjencës për financimin e projektit “Forcimi i Kapaciteteve të Shërbimit Shqiptar të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”; të VKM nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar për Mbrojtjen Civile”; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1.Miratimin e përdorimit të fondit të emergjencës në shumën 5,000,000 lekë për financimin e projektit “Forcimi i Kapaciteteve të Shërbimit Shqiptar të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”.

Për këtë të kryhen veprimet në programin buxhetor si më poshtë :

- Pakësohet : Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art.602 për shumën 5,000,000 lekë në zërin “Ndërhyrje parandaluese”.
- Shtohet : Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art.231 për shumën 5,000,000 lekë për financimin e projektit “Forcimi i Kapaciteteve të Shërbimit Shqiptar të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”, bashkëfinansim për ndërtimin e objektit të Stacionit të MZSH Lezhë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI



Prot 5168/
07.11.23



KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 389/8 Prot.

Lezhë, më 16 .05.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" të ndryshuar, "ligjin nr.68.datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjin nr 45/2019 "Për mbrojtjen civile" VKM në nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 , datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.39, datë 10.05.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për përdorimin e fondit të emergjencës për financimin e projektit "Forcimi i kapaciteteve të shërbimit shqiptar të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

